




**REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK– MUNICIPALITY OF JUNIK**

Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, pika c të Ligjit Nr.03/L-40 për Vetëqeverisjen Lokale, neni 40 dhe 57, paragrafi 57.1 i ligjit Nr. 04/L-005 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 2004/18 për Tregtinë e Brendshme, Rregullorës (MAPL) nr. 01/2017 për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të komunës, si dhe nenit 10 pika a, nenit 22 paragrafi 22.1 pika 3, të Statutit të Komunës së Junikut, Kuvendi komunal në mbledhjen e mbajtur me dt.27.12.2019 miraton këtë:

**RREGULLORE PËR NDRYSHIM DHE PLOTËSIM TË RREGULLORËS PËR
CAKTIMIN E ORARIT TË PUNËS PËR SUBJEKTET AFARISTE NË TERRITORIN E
KOMUNËS SË JUNIKUT**

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Me këtë rregullore përcaktohet fillimi dhe mbarimi i Orarit të Punës për të gjitha veprimtaritë afariste, hoteliere, zejtare dhe shërbyese të cilat e ushtrojnë veprimtarinë e tyre ekonomike në territorin e Komunës së Junikut.

Neni 2

Të gjitha subjektet afariste të themeluara dhe të regjistruara në pajtim me dispozitat ligjore që ushtrojnë veprimtari afariste janë të obliguara ti përmbahen orarit të punës të përcaktuar me këtë Rregullore.

Neni 3

Orari i fillimit dhe mbarimit të punës i përcaktuar me këtë Rregullore duhet të vendoset në hyrje apo në vend të dukshëm të objektit, në të cilin kryhet veprimtaria afariste dhe duhet saktësuar:

- a) Fillimi dhe mbarimi i Orarit të Punës,
- b) Ditët që nuk punohet,
- c) Rastet e veçanta,
- d) Pauzën ditore.

II. ORARI I PUNËS

Neni 4

1. **Orari i Punës** duhet të përcaktohet në bazë të llogaritjes verore dhe dimërore, në intervale kohor:
 - a) periudha verore fillon me 1 Prill dhe zgjat deri më (31 Tetor) të vitit.
 - b) periudha dimërore fillon me 1 Nëntor deri më 31 Mars të vitit.

Neni 5

1. **Subjektet afariste të organizimit të tregtisë me pakicë** mund të punojnë prej të hënës deri të shtunën dhe atë:
 - a) Në kohën verore orari i punës fillon nga ora 6:00 dhe përfundon në ora 24 .00,
 - b) Në kohën dimërore orari i punës fillon nga ora 7:00 dhe përfundon në ora 23.00.
2. Përjashtim nga dispozitat e nenit 5 pika a, b dhe c të kësaj rregulloreje, bëjnë objektet që gjenden jashtë vendbanimeve dhe mund të punojnë me shumë se orari i përcaktuar me pëlqimin e administratës lokale.
3. Të dielave dhe ditëve të festave nuk punojnë.

Neni 6

Orari i Punës për dyqanet zejtare, do të jetë:

- a. Periudha verore, prej orës 8:00 deri në ora 20:00,
- b. Periudha dimërore, prej orës 8:00 deri në orën 18:00,
- c. Ditën e fundjavës (të dielën) dyqanet zejtare nuk do të punojnë, përveq: salloneve të ondulimit, floktoreve, autolarjeve dhe furrave të bukës.

Neni 7

1. Furrat e bukës punojnë qdo ditë prej ores 04:00 deri në orën 22:00

Neni 8

1. Orari i punës nëpër dyqanet e ondulimit dhe floktoreve është siq vijon:
 - a. Periudha verore prej 1 Prillit e deri me 31 Tetor prej ores 04:00 të mengjesit deri në orën 21:00,
 - b. Periudha dimërore prej 1 Nëntorit deri më 31 Mars prej orës 05:00 deri në orën 20:00.

Neni 9

1. Orari i Punës për depot e artikujve ushqimor, depot e materialit ndërtimor dhe në ndërmarrjet që merën me prodhimin e betonit, do të jenë:
 - a. Periudha verore prej 7:00 deri në ora 20:00,
 - b. Periudha dimërore prej orës 8:00 deri në ora 18:00.
2. Ditën e fundjavës (të dielën) subjektet e përmendura në paragrafin një (1) nuk do të punojnë.
3. Orari i Punës në ndërmarrjet ndërtimore (ndërtimi i ulët dhe i lartë) do të jetë:
 - a. Periudha verore, prej orës 7:00 deri në ora 18:00,
 - b. Periudha dimërore, prej orës 8:00 deri në 17:00.
4. Ndërmarrjet ndërtimore, në raste të jashtëzakonshme për shkak të natyrës së punëve, me leje të posaçme të cilën e lëshon Drejtoria për Shërbime Publike dhe Inspeksion, mund të punojnë me orar të zgjatur deri në orën 23:00.

Neni 10

1. Orari i Punës për gjelltores dhe qebaptore, do të jetë:
 - a. Periudha verore, prej orës 6:00 deri në ora 24:00,
 - b. Periudha dimërore, prej orës 7:00 deri në orën 23:00.
 - c. Ditën e pushimit e përcaktojnë vet bizneset.

Neni 11

1. Orari i Punës në vetëshërbime, supermarkete, qendra tregtare, qendra rekreative dhe dyqane ushqimore, do të jetë:
 - a) Periudha verore, prej orës 7:00 deri në ora 23:00,
 - b) Periudha dimërore, prej orës 8:00 deri në 23:00.

2. **Orari i Punës në dyqane tregtare të tekstilit, dyqane të këpucëve, dyqane të pajisjeve teknike shtëpiake "teknikës së bardhë" dhe veprimtarive tjera jo ushqimore, do të jetë:**
 - a. Periudha verore, prej orës 8:00 deri në ora 21:00,
 - b. Periudha dimërore, prej orës 8:00 deri në 18:00.
3. Ditën e fundjavës (të dielën) veprimtarit në paragrafin 1 të këtij neni nuk do të punojnë perveq dyqani kujdestar, ndërsa veprimtarit në paragrafin 2 të këtij neni nuk do të punojnë.

Neni 12

1. **Orari i Punës në kafene, do të jetë:**
 - a. Periudha verore prej orës 6:00 deri në ora 24:00,
 - b. Periudha dimërore prej orës 7:00 deri në ora 24:00.
2. **Orari i Punës në hotele, motele dhe restorante është i njëjtë në dy sezonat dhe fillon prej orës 7:00 - 24:00.**
3. **Hotelet dhe Motelet** mund të punojnë pa ndërprerje vetëm me shërbime të fjetjes, mirëpo duke kufizuar të gjitha shërbimet tjera (restaurante, bare, etj), pas orarit të caktuar me pikën 2 të këtij neni.
4. **Veprimtarive të lartpërmendura në pikën 2 të këtij neni, nuk iu lejohet shërbimi për musafir jashtë objektit – tarraca pas orës 24:00.**

Neni 13

1. **Orari i Punës në Kafene – Bare, është i njëjti për të dy sezonat, fillon në orën 07:00 dhe mbaron në orën 24:00.**
2. **Orari i Punës në Disko - Klube është i njëjti për të dy sezonat, fillon prej orës 18:00 dhe mbaron në orën 24:00.**
3. **Orari i Punës për Internet – Kafe fillon në orën 8:00 dhe mbaron në orën 23:00.**
4. **Veprimtaritë Afariste të cekura në paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni gjatë orarit të rregullt të punës mund të përdorin muzikë deri në orën 23, gjithmonë në pajtim me Ligjin për Rendin dhe Qetësinë Publike, si dhe Ligjin për Mbrojtjen nga Zhurma.**

Neni 14

Stadiumet e improvizuara të futbollit dhe **Palestrat** sportive punojnë pa kufizime.

Neni 15

1. **Orari i Punës në Barnatore, Laborator, Ordinanca dhe klinika private** do të jetë i njëjtë në të dy sezonat, fillon në orën 07:00 dhe mbaron në orën 24:00.
2. **Në raste emergjente**, të dielave dhe gjatë festave shtetërore, mund të punojnë edhe jashtë orarit të paraparë sipas paragrafit 1 të nenit 16.
3. **Barnatoret e qytezës** do të punojnë sipas paragrafit të parë të këtij neni, por së paku një prej barnatoreve (nëse janë dy e ma shumë) do të kujdestarojnë non-stop 24 orë.
4. Orarin e kujdestarisë do ta përcaktojnë vet barnatoret. Orari do të hartohet për një muaj dhe do ti dorëzohet Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Inspeksion për muajin vijues. Barnatoret kujdestare duhet të shpallen në mjetet e informimit me numër të telefonit dhe adresën e lokalit kujdestar.

Neni 16

Veprimtaritë afariste përkatëse mund ta zgjasin orarin e punës me rastin e festave të parapara me Ligjin për festat zyrtare, deri në orën 01:00 (të mëngjesit) me përjashtim të datës 1 Janar për shkak të festës së Fund vitit ku fillimi i aktivitetit të veprimtarive është i pacaktuar. Për këtë rast veprimtarit afariste nuk janë të obliguara të paguajnë taksën komunale për zgjatjen e orarit.

Neni 17

Orari i punës për tregun e gjelbër dhe atë të kafshëve, do të jetë:

- a) Tregu i gjelbër të Premtën tërë ditën
- b) Tregu i kafshëve të Premtën tërë ditën.

Neni 18

Objektet për shitjen e karburanteve, do të punojnë në këtë orar:

1. Në periudhën verore dhe dimrore prej ores.....06 deri 24,
2. Një Pikë e shitjes do të kujdestarojnë non-stop 24:00 orë në të dy sezonat,
3. Orarin e kujdestarisë do ta përcaktojë administrata lokale me kërkesë të subjektit afarist, të cilët merren me shitjen e karburanteve,

4. Orari do të caktohet për një muaj dhe do ti dorëzohet Inspektorit të Tregut në fund të muajit për muajin vijues,
5. Të dielave nuk punojnë përveq pika e shitjes që është kujdestare.

III. ZGJATJA E ORARIT TË PUNËS

Neni 19

1. Për punë më të gjatë se orari i paraparë, duhet bërë kërkesë për të marr pëlqimin nga Drejtoria për Shërbime Publike dhe Inspeksion.
2. Kërkesa nga subjektet afariste për zgjatjen e orarit të punës duhet të parashtrohet 48 orë më parë, ndërsa me Aktvendim për zgjatje të orarit të punës Drejtoria për Shërbime publike dhe Inspeksion si dhe Policia e Kosovës në Junik do të njoftohen 24 orë përpara.
3. Subjektet afariste të cilat punojnë me orar të zgjatur, ushtrojnë veprimtarin e tyre gjithmonë në pajtim me ligjin për rendin dhe qetësin publike, si dhe ligjin për mbrojtje nga zhurma.
4. Veprimtarite afariste të cilave iu lejohe zgjatja e orarit të punës në bazë të pagesës përkatëse janë:
 - a. Hotelet, motelet dhe restorantet, mund të zgjasin orarin deri në ora 02:00,
 - b. Kafenet dhe disko klubet në zonat para-urbane mund të zgjasin orarin deri në ora 02:00 ndërsa për ato në zonat urbane nuk lejohet zgjatja e orarit,
 - c. Furrat e bukës, gjelltoret dhe qebaptoret mund të zgjasin orarin deri në ora 02:00,
 - d. Dyqanet tregtare ushqimore, supermarketet, si dhe kiosqet, mund të punojnë 24 ore, me pëlqim paraprak nga DSHPI,
 - e. Ordinancat private mund të punojnë pa ndërprer 24 orë, me pages mujore 100.00 euro.

Neni 20

1. Kriteret dhe dokumentet e nevojshme për aplikim të zgjatjes se orarit të punës janë:
 - a. Plotësimi i kërkesës me arsyeshmërinë për zgjatje të orarit të punës,
 - b. Për zgjatje mujore të orarit, duhet të specifikohen datat sipas planit mujor të punës,
 - c. Qertifikata e biznesit (kopje),
 - d. Leja e pronarit apo personit të autorizuar (kopje),
 - e. Aktvendimi për plotësimin e kushteve hixheniko-teknike sanitare të lokalit (kopje),
 - f. Pagesa për zgjatje të orarit.
2. Drejtoria për shërbime publike dhe inspeksion e mbanë të drejtën e kërkimit të dokumenteve tjera shtesë sipas nevojës.
3. Qdo pëlqim që lëshohet për zgjatje të orarit të punës nga Drejtoria për Shërbime Publike dhe Inspeksion duhet ti dërgohet edhe Policisë së Kosovës – Junik.

Neni 21

Subjekteve afariste për aktivitetet e organizuara në hapsirat publike ju nevojitet pelqimi për shfrytëzim, nga Drejtoria për Shërbime publike dhe inspeksion, si dhe plotësimi i kushteve për parkim dhe qarkullim të lirë të transportit.

Neni 22

1. **Taksat për pagesë** për zgjatjen e orarit të punës në suaza ditore në Komunën e Junikut llogariten siq vijon:

Nr.	Llojet e Veprimtarive	Pagesa për një/orë
1.1	Veprimtaritë hoteliere (hotelet, motelet, restaurantet, diskoclubet)	5;00 €/orë
1.2	Qebaptoret, kafiterit, supermarketet, dyqanet tregtare, ushqimotre dhe te ngjashme	3;00 €/orë
1.3	Te tjera	4;00 €/orë

2. **Taksat për pagesë** për zgjatjen e orarit të punës mund të lëshohet edhe në suaza mujore për të cilën duhet paguar:

Nr.	Llojet e Veprimtarive	Pagesa për një/ muaj
2.1	Veprimtaritë hoteliere (hotelet, motelet, restaurantet, diskoclubet)	100.00 €/muaj
2.2	Qebaptoret, kafiterit, supermarketet, dyqanet tregtare, ushqimotre dhe të ngjashme	50.00 €/muaj
2.3	Të tjera	80.00 €/muaj

3. Për subjektet afariste të cilat posedojnë Salla ahengjesh (dasma, syneti, kanagjegj, ditëlindje, matura dhe të tjera të ngjashme), për tejkalim të ortarit të punës, respektivisht pas orës 24.00, janë të obliguara që për qdo aheng të paguajn 50 € për ditë në emër të vazhdimit të orarit të punës.

Neni 23

Subjektet afariste të përcaktuara më këtë Rregullore mund të zgjasin orarin e punës me rastin e festave shtetërore, fetare, dhe me këtë rast nuk janë të obliguara të paguajnë taksat komunale.

IV. DISPOZITAT MBIKEQYRËSE

Neni 24

Për mbikeqyrjen, zbatimin dhe respektimin e kësaj Rregulloreje do të kujdesët Drejtoria për Shërbime Publike Inspeksion Mbrojtje dhe Shpëtim në bashkëpunim me Policinë e Kosovës.

V. DISPOZITAT NDËSHKUESE

Neni 25

1. **Të gjitha subjektet afariste** të cilat nuk e respektojnë fillimin dhe mbarimin e orarit të punës të përcaktuar më këtë Rregullore do të dënohen me gjobë si vijon:

1.1. Personat juridik 300 €

1.2. Personat fizik 150 €

2. **Të gjitha subjektet afariste** të cilat orarin e punës nuk e vendosin në hyrje apo në vend të dukshëm të objektit në të cilin ushtrohet veprimtaria afariste do të dënohen në shumë prej 50 €.

3. **Të gjitha subjektet afariste** tek të cilat konstatohet se kanë zgjatur orarin e punës pa pelqimin e leshuar nga Drejtoria për Shërbime Publike dhe Inspeksion, do të dënohen me gjobë si vijon:

3.1. Personat juridik 200 €

3.2. Personat fizik 150 €

4. Në rast se subjekti i mbikëqyrur nuk ban ekzekutimin e gjobës brenda afatit të dhenë me Vendim, Inspektori mund të inicojë procedurë kundervajtëse në Gjykatën kompetente mbrenda afatit prej pesëmbëdhjet(15) ditësh nga dita kur vendimi bëhet i plotfuqishëm.
5. Mjetet e mbledhura derdhën në Buxhetin Komunal.

6. Drejtoria për Shërbime Publike Inspeksion Mbrojtje dhe Shpëtim mbanë të drejtën për të gjitha subjektet afariste, që në rast të mos respektimit të kodit afarist, rrezikimit të sigurisë së qytetarëve si dhe prishjes së qetësisë të ju merret pelqimi për zgjatjen e orarit të punës.

VI. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 26

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje komunale mbi caktimin e orarit të punës të subjekteve afariste, shfuqizohet Rregullorja për Orarin e punës për subjektet afariste në territorin e komunës së Junikut me nr.001/3579 e aprovuar më datën 30.11.2010.

Neni 27

Subjektet afariste janë të detyruara ta harmonizojnë orarin e punës me dispozitat e kësaj Rregulloreje në afatin porej 8 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje.

Neni 28

Kjo rregullore hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokolit të ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në web faqen zyrtare të Komunës.

Me 27.12.2019
Në Junik

Kryesuesi Kuvendit Komunal
Muharrem Krasniqi

